



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK GJIROKASTËR

Nr. 380/3 prot

Data 01.08.2024

Lënda: Njoftim për vend të lirë

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, “Përnxitjen e punësimit”; të ligjit nr.15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”; të udhëzimit nr.14, datë 27.05.2021, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”,

Ofruesi publik i AFP-së Qendra e Formimit Profesional Publik, Gjirokaster u njofton krijimin e vendit të lire për pozicionin:

Specialist ne sektorin e administrimit te formimit profesional.
(Specialist.) - 1 person (Gjirokastër)

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit



Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë nivelin arsimor master profesional ne fushen e shkencave ekonomike.
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në pozicione te ngjashme
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicioni;
 - b) jetëshkrimin (CV-në);
 - c) kartën e identitetit;
 - d) diplomën
 - e) librezën e punës;
 - f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
 - g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
 - i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
 - j) vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
 - k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm;
- të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, Brenda datës 12.08.2024

DREJTOR

Mihare LAPA

